

EPPC Albania kërkon një **Përfaqësues Shitjesh B2B (për Veriun e Shqipërisë)** për klientin e saj, i cili është një ndër kompanitë lider në treg në fushën e shpërndarjes me shumicë të veglave të punës, si dhe aksesorët e ndryshëm që lidhen me to.

## Përgjegjësitë Kryesore:

- Analizon nevojat e klientëve dhe bashkëpunon me ta për zgjidhjen e nevojave të tyre;
- Merr porositë tek klientët ekzistues dhe i informon për produktet që kompania ofron;
- Viziton pikat e shitjes të zonës që mbulon sipas programit ditor;
- Prezanton në menyrë profesionale markat që kompania tregon;
- Mirëmban klientët ekzistues dhe është në menyrë të vazhdueshme në kërkim të klientëve të rinj;
- Respekton çmimet e vendosura nga kompania;
- Përgatit planin ditor dhe raportin tek supervizori i tij;
- Përgatit analiza mujore për shitjet mujore duke u bazuar në target-in e tij.

## Kërkesat për këtë pozicion janë:

- Të ketë arsim të mesëm (diploma universitare përbën avantazh);
- Eksperienca e ngjashme së paku 2 vite, përbën avantazh;
- Të ketë aftësi të mira komunikuese dhe negociuese;
- Të jetë i aftë të punojë në grup;
- Të posedojë **leje drejtimi** dhe të ketë **disponibilitet për të udhëtuar**;
- Të ketë njohuri të mira të programit Office;
- Përbën avantazh njohuria në përdorimin e programeve financiare.

## Të dhënat:

<b>Pozicioni:</b>	Përfaqësues Shitjesh B2B (Veri);
<b>Vendndodhja:</b>	Tiranë;
<b>Orari:</b>	48 orë;
<b>Raporton tek:</b>	Menaxheri i shitjeve;
<b>Pagesa:</b>	Shumë e mirë ( <i>fikse + bonuse+makinë</i> );
<b>Kontrata:</b>	Sipas Kodit të Punës;
<b>Aplikimet mbyllen:</b>	05.09.2018

## Si të aplikoni:

Për të aplikuar për këtë mundësi punësimi, ju lutemi dërgoni CV-në tuaj dhe dokumentet e tjera shoqëruese duke **përmendur pozicionin për të cilin aplikoni** në adresën e e-mail<sup>it</sup>:

[recruitments@eppc.al](mailto:recruitments@eppc.al)

Ju do të kontaktoheni vetëm në qoftë se CV-ja juaj dhe dokumentet shoqëruese do të kualifikohen.  
Tek ne CV-ja juaj është e sigurt dhe trajtohet në konfidencialitet të plotë.